

TINGËLLIMA (E NDJESHMËRISË) E POETES ELIFE LUZHA

VDEKJA E DITËLINDJES



Elife Luzha

TINGËLLIMË E NDJESHMËRISË

Libri “Vdekja e ditëlindjes” e krijueses Elife Luzha është libri i tretë me poezi dhe njëkohësisht është befasia e tretë që i sjell lexuesit. Origjina e frymëzimit të saj vazhdon duke u mveshur edhe më estetikisht ashtu si vjen bota e saj ideore duke u zgjëruar. Në këtë përmbledhje vjershash kjo krijuese del edhe më kërkuese ndaj vetes dhe arrinë të njësoj lexuesin me poezinë e saj duke e gjallëruar dhe nxitur estetikisht nëpër gjithë situatat dhe çastet e saj të frymëzimit. Poezitë e këtij libri vijnë si një tingëllimë e ndjeshmërisë së saj, e cila në këtë rast mund të identifikohet si një shenjë e afinitetit krijues të saj. Kjo shënon një avansim të autores si një krijuese që procesin e shkrimit tanimë e merr si një prodhim të nevojës së botës së brendshme, si një prodhim të konceptit të saj për të dhe njëkohësisht kjo shënon një stad të vetëdijës së saj letrare që gjithësesi tani është i formësuar. Në libër hetohet një shqetësim përmanent që kalon vazhdimisht në krijim, në prodhimin e materializuar të ndjenjës duke bartur ide të veçanta. Gjithçka që e turbullon ose e gëzon autoren, paraqet frymëzimin e saj. Jeta, vërshuese me befasitë dhe të papriturat e saj, klima shoqërore shpesh edhe si produkt i së kaluarës, vetmia e dhembja i krijojnë një hapësirë meditative që e bën të asociacionon në shumëkuptimisht poezia e saj. Natyrisht kjo është një përparësi për librin. E veçanta e librit është këmbëngulësia e autorës që ta thotë të tërën, gjë kjo që në shumë raste e sforcon paraqitjen krijuese të saj duke bërë edhe ndonjë përgjithësim, por kjo më tepër mund të merret edhe si një segment i

pasionit të padëgjueshëm për komunikim me lexuesin. Poezitë tregojnë ndjenën e fortë të kujtimit për vendlindjen, të dashurëve dhe forcës së bukurisë së jetës dhe natyrës. Rrethanat dhe kryengritësia ndaj tyre, janë një pjesë tjetër e kësaj bote poetike, si gjendja e caktuar ndenjësore në perceptimin e caktuar ndjenjësor, në përcaktimin e rrjedhës së kohës dhe inatit të njerëzve në të (korbat, zvarranikët, lukunitë), janë qeniet që kohës nuk i përballojnë dot. Disa nga poezitë janë shenja kujtesore të përjetimeve subjektive (Njeriu perendi apo poezia Të pagjeturit), duke reflektuar ndjeshmërinë e saj ndaj dhembjes që e rrethon me një forcë kurajoje morale të lartë. Autorja mjete ka kordelet paqësore në poezinë „Të pagjeturit“ ajo është mjaft e rreptë sepse tanimë: Në makth / retë u mplakën / mbi kokën time / pjalm bryme zbardhon. Gjithë atë që ka në mendje dhe në subjektivën e saj, autorja e bën libër përmes udhës së frymëzimit i cili në vazhdimësi vjen ashtu si e ndien ajo botën dhe kujtimin, atë që është dashur të mbetet e të mos harrohet si një e djeshme. Autorja nuk kalon kalimthi mbi asnjë motiv, por rrinë zgjuar mbi çdo ndjenjë e ide për t'i shpalosur deri në fund vullnetshëm dhe drejtpeshueshëm, çdoherë duke qenë pashmangshëm kritike ndaj emocionit shpërthyes. Në këto poezi vërehen edhe degëzime të të njejtit frymëzim dhe kjo bëhet natyrshëm sepse dalin si pjesë të objektivit të saj krijues, por të shfaqura me një gjuhë tjetër dhe në kontekste të ndryshme. Duke qenë kështu, këto degëzime dalin të efektshme në kuptimin e ofrimit më të plotë të botës së autores, statusit të saj si krijuese. Këmbëngulëse në qërimin e hesapeve me veten dhe me atë që e rrethon krijuesja është në rrënjën e frymëzimit, të cilën me vite e ka hulumtuar, ndaj del me tri libra për një kohë të shkurtë dhe këto janë prodhime të paqetësisë së saj shpirtërore, meqë dy decenie ka jetuar larg çdo gjëje të dashur, por librat janë dëshmia se ajo ishte afër çdoherë. Ndoshta për këtë shumë poezi i përshkon një diskurs moral edhe atë përmes personazheve historikë si janë Gj. Kastrioti, mbretëresha ilire Teuta, historia e Arbërit t.j. Libri “Vdekja e ditëlindjes” ka një frymë shumë të veçantë frymëzimi, një leksik shumë të pasur dhe reflekton një forcë krijuese të autorës, gjë që na bën të besojmë se ajo do të na jep edhe libra të tjerë.

Qibrije Demiri - Frangu

Dans korbash

Dans korbash

Në vargmale e lëshova zemrën

Si zogun

Legjenda fshau

Kohe lukunish pabesia mpreh dhëmbët

Akrepat e orës tani thyer

Dans luhet

Me krrokamë korbash

Dang dang krra krra

*E mëngjeseve
Gjarpërinjtë helmosin barin*

Plagët e gjalla

*Fytyra mumjesh mbajnë udhët
Ujë kroi s'ka as për ilaç
Gjergj Elez Alisë t'ia freskojë plagët
Tek logu mbinë legjenda
Për sytë e motrës
Nuk e di si
Gjergji me nëntë plagë
Gjallë mbet*

Në krah engjëjsh

*Më lejo ta heq mallin
Si shaminë ime ëmë
Shtrëngimi në gjoks
Frymëmarrjen ma ndalon
Deri në palcën e ashtit
Ta ndjejë dashurinë tënde
Aromën e blerimeve tua ta nuhas
Dhe të dehem në prehrin tënd
Duke pirë mushtin nga duart e tua
Të preku hënën*

*Më lejo
Të shtrihem në balten tënde
E të bëhem pis si atëherë
Unë fëmijë e lazdruar
Tek fole e dallëndyshes
Të shoh syrin e pranverës
A ka ndryshuar*

*Mos e shtro sofrën për mua
Ja shikimi yt
Është bukë*

Është ujë

*Ja prushin tim ha
Mbi gjoksin tënd*

*Po më zuri gjumi
Thuaju zogjve të malit
Në krah engjëjsh
Në ëndrrën e bardhë Ajo
Po fle*

Në Trieshtë

*Teksa po rrija në tavernë
Dy pëllumba fluturimin ndalën
Mbi hijen time
Tek sheshi pranë bregdetit
Në Trieshtë
Unë njeri me zemër pëllumbi
Me troha buke i gostita
Pëllumbat shpirtnjeriu
Çukitën
Derisa urinë e shuan
Ah
Lotët në sytë e mi
Duar fëmijësh
Lypsarë të Kosovës
M'u kujtuan
Imazh i trishtë
I ndërgjegjes sonë
Të copëzuar*

Mëkati i bukur

*Këngën ia dhurova dhembjes
Që të fle mbi ëndrra
Pranverave
Të dashurohet*

*Zambak për flutura
Në kopshtin e zemrës
Mbolla*

*Shtigjeve të muzgëta
Zura xixëllonja
Drejt dritës së agsholtë
Ecja*

*Mëngjeset e veta
Me pika loti
I numërova*

*Mëkat bëra
Duke të pritur ty
Trëndafilat i copëtova*

Gjeografia e zemrës

*Nata e përqafoi qiellin e purpurt
Tek syri gjysmë i hapur
I yllit në zgjim*

*Polet në faqen e tokës shtrirë
Ia dëgjojnë frymëmarrjen
Erërave
Deri në zemër*

*Syri mat e ç' mat
Horizontet e shkrumbuara
Me ajër të akullt
Matematikë e gabuar
Me gjakun e zemrës sime
Vijëzon kufijtë
E atdheut të tkurrur*

Filli i ri

*Varka e shpresës sërish u përmbys
Dhe lotët u bën një me detin*

*Valën me not e qetësova
Trishtimin me guaca gjerdan
I vura shpirtit tim
Rrugët e ndara me zemër i spërkata
Magjishëm në trupin tim e ngjiza
Makthin përshëndeta në vegim*

*Kë do të takoj
Fushat e bleruara
A gurët e thepisur
Nuk e di*

Lutja

*Tek bardhësi e resë
Lutja ime ulet e pi ujë
Flatra i vë shpresës*

*Dita që në të zbardhur ftohet
Retë e lëngëzuara
Ma prishin magjinë
E ëndrrës për një çast
Më zë frika*

*Përgjigje s'marrin
Buzët e mia
Shkrumb
Edhe kur qielli lëngëzon
Mallin e vet*

*Simfoni e trishtë
E çapkënllëqe të kohës jorgovan
Hija e zhgënjimit më ndjekë
Me krahët e mi*

Bën lojë n' horizont

*Lutja ime
Drejtëz e lakuar shprese
Tek retë e vrenjtura
Rutinë dhembjeje bëhet*

Pafundësia e marrëzisë

*Udhët e lakadredhëta
I mbulon mjegulla
Fushave
Era e trazuar shakullinë
Çmendurisht luan
Me gjelbërimin e tyre
Pritja trokëllinë
Si pikla kroi
Mbi shpirt bën vrimë
Derisa netët i hanë ditët
Me dhëmbë shtrigash
E gjaku i jetës rrjedh
Mbi humnerat e djersitura
Me hukama gjarpërinjsh
Kambana nuk dëgjohet
Nga re të tendosura
E ne flemë mbi tmerrin
Merimangat qosheve
Rrjetzojnë prita
Gosti shumëkëmbëshash
Zvarranikësh
Kroi rrjedh pika-pika
E pritja trokëllinë*

Ëndrra e trishtë

*Në djep yjesh
Më përkund nata
Si mbi qepallë Tanushe*

*Ëndrra me teket e veta
Lehtë mbështet
Në nënkresën time të pendëlt*

*Me butësi engjëlli
E bardhësi zemre
Pafajsisht pëshpëriti*

*A e din çka do të thotë
Të rrish me thnegla*

*E trembur u zgjova
Me rreze hëne
Natën shkunda*

*As ëndrrën më nuk e gjeta
Iku me teket e veta*

Unë ia di emrin

*Shkëlqimin ma pate lakmi
Ndaj hapin më godite
Me ngjyrë mavi blerimin
E deshe në pikturë*

*Dikur
Puhizë dashuria
Me vello ëndrrat nusëroi
Me zogun e blerimit
Vallëzova
Me fluturat
Demonit në radhë
Pre i isha
Tek fushë vashërore
Që vetëm unë ia di emrin
Në zemër e ruaja
Sa kohë*

Ti
Demonët radhitë
Në vallen e shtrigave nudo
Duke spërkatur tokat e gurta
Me ngjyrë mavi
Unë eca
Drejt ditës nusërore
Vellon e zbukurova
Me kordele paqësore

Të pagjeturit

Copa kristali sytë e mi
Det dhembja parzmën godet
Lot e mall maratonomak
Nga dhimbje nënash
Tremben çakejt
Amanetet stinët copëtojnë
Eshtrat t'ua mbjellin sërish

Fosfori xixë stralli
Feniksin rizgjon
Dheu i ngrohët
Hapet si plagë zemre
Një pëllëmbë toke
Për ty ooo vëlla

Në makth
Retë u mplaken
Mbi kokën time
Pjalm bryme zbardhon
Duke i gdhendur kujtimet në gur
Që sa kohë
Në lajthitje ëndrrat
Bimojnë dhembje
Netëve pafund
Varg lumi
Në syrin e nënave

Pa gjumë

Dhembje malli

*Pikla shiu i ftohët
Bie në dritaren e shpresës
Kujtimi
Me vrap kaprolli
Ik fati
Thepmajave
M'u valëvit zemra
Mbështjellë e kam
Me fletët e dushkut
Të malit tim
Pranverave mbi lisa
Pipthat të brishta gjelbërojnë
Mashtrimi ve kurorë
Fluturat me ngjyra shprese
Peizazhin e prekin
Ah
Pastaj vjen vjeshta
Pafund*

Ecja monotone

*Hëna shtrirë në trotuar
Kalimtarët me rreze
Spërkat
Në duar të shtrënguara
Të dashuruarve
Kujtimi bulëzon
Sërish*

*Unë fillikat vetëm
E zbukuruar me lotin
Shëtis nëpër Prishtinë
Si ballë hëneje
E ndritur me shpresën*

*Sa shume desha
Të takoj ty
Gjithçka e imja*

*Si në planet tjetër ecja
Yje e hënë mu tretën në sy*

Lumi

*Si fllad mali
Gjarpëron
I pandier
Si
Puthja e parë e
Pafajësisë*

*Plot të panjohura
Të dëgjuara fshehtësira
Në zemër të madhe
Se si i ngujon*

*Me plagë zemrash
E dashuri ëndrrash
I ngreh kullave mur
Pastaj jeta aty zgjon*

*Bartë edhe shumë gjëra
Din shumë të pathëna
Në krahët e fluturave
Ti ëndrra mbjellë*

*Fushave i dhuron blertësi
Tokës zemrën ia freskon
Ëndrrën time të vetme
Ta besova
Vetëm ti ma mëkon*

Vdekja e ditëlindjes

Në vend të parathënies

*Majat e maleve
Me parzmën time i kam mprehur
Mbi fosforin tim sofrën e kam shtruar
Gosti për perëndi
Me këngë rituale
Duke i pagëzuar brezat
Unë re mbi re
Largova myshkun e shekujve
Rrugëve kah eci
E ndjej trokun e kalit
Heroit të Motit të Madh
Hijen ia preku
Në Dardani u pagëzua kuq e zi
Duke bere epoka
Me ngjyrën e dejve të mi
E ty
Nga ç' nëmë nëne të është gurëzuar
zemra
Thith gjakun e dejve të mi
E perëndive sofrën ua trazon
Mijëra vjet ditëlindjen ARBËRI
Ta këndoj*

S' të pashë më

*Me vargun tim stinët ledhatova
Me fjalë nuk zihet bota më thoshe
Sa herë shkrova ndonjë rimë
Bukurinë ëndrrës ia shtoja*

*Nënshkrimi yt në çdo radhë
Vulë shpirti pa ngjyrë
Pa dashur në vargun tim
Për ty
Mendimi fërfërinë si pelerinë*

Ti
Nga vargu me ike pa zë
Me rrënjë rimën e shkule

Dritaret punë nuk bënë
I hapa e mbylla si zemrën
Varg e rimë u hirëzuan
Në prushin e ndjenjës

Atdheu

Në prehrin tënd agimeve
I lidha polet e maleve gjigante
Rrugët m'i shndërrova në tunel të
pafund
Kurore e dhembjes
Blerimi peng ma mbajti
Te fushat tua
Lumenjtë varguar në sy
I ruajta për mallin tim
Me le
Pse të lash
Këngë e dasmës e pakënduar
Mbet
Sa kohë unë Teuta
Fushën e gërreva me grushte
Në kështjellën e zemrës
E ruajta me fleta ftonjsh
Dashurinë
Një ditë apoteozat
M'i shkund tërmeti i mallit
Relievi im i pafund që
Çdo stinë blerimet i spërkat
Medet

Mesazh në telefon

Në copa zemre e kodova qëndismë

*Mesazhin që ma dërgove
U deshifrua dhembja
Përtej palce
Qëndisur tatuazh
Ëndrrat i balsamosa
Në galaksinë e yjeve*

Jeta

*Hëna rrugët m'i dritëroi
Në kopshtin me trëndafila
Me gugamë pëllumbash
Pira kafënë
Vetëm qukapiku dyzon vrima
Tek druri i harkuar
Shtëpi të re për banim
Thellë më bulëzuan mendimet
Për jetën*

Larg teje

*Në fushën e kujtimit
Mendimet garojnë
Nëpër honet e kohës mbarsur
Si gazele dashuria ime
Në fushën e pikëllimit shtrirë*

*Po largohem
Dëshirat
Në rreze dielli i kam varur
Blerimin ta ledhatojnë në agmi
Bjeshkës
Me ia shkri akujt*

*Çdoherë ta puthi ballin
Netëve të ethta
Ta zgjoj këngën
Kur mërzia të ketë kapluar Ty*

*Ta kujtoj ëndrrën
Mëngjeseve kur të jesh zgjuar
Pallën të ta ndrijë
Që varur e mbajnë
Sa brezni
Plagën të ta thaj
E imja Arbëri*

Qartësi

*Si në kuvertë e mbyllur
Fjala ime
Peshon në metafora
Me rrënjë lashtësie
Mprehur
Metaforat t'i deshifroj desha
Toka u dridh tërmet
Lisi u rrëzua pa u djegë
Fusha pa logje mbeti shkret
Mjegullat
Rrjete merimange
Ngulfasin ajrin
Sprija thith gjak
Ne dejtë e mi prushi flakë
Vaji bar plage
Orakujt në metastazë
Të gjitha janë
Tek fjalët e mia
Të mbyllura në metafora
Si në kuvertë
Le të dridh tërmeti
Le të njëzohen lumenjtë
Ti pellazgia ime shpërthe
Prek qiejt*

Vdekja e ditëlindjes

Autostradë dhembja

*Rrugëve të mia pa kthim
Thërimia thërima m'i bëri
Ëndrrat e xhamta
Shpirti pasqyrë dashurie
Shpresoi ardhjen tënde*

*Nuk erdhe
As kur ditëlindja ime vdiq
Në kremten që nuk filloi
Ajri i jeshiltë
Më shkundi kujtimin*

*Tek mjegulla e dendur
E vara qepallën e mallit
Që më thepoj zemrën*

Nëna ime rruzare

*Në gjunjë i përkulem
Nderit dhe madhësisë tënde*

*Në ballin tënd kalëron vuajtja
Mozaik i shpirtit*

*Tek qielli i ëndrrave
Dhimbjet radhitë*

*Duke i ngujuar lotët
Në fushën e ndjenjës*

*Që të shpërthejnë për gëzimet
E takimeve tona të mallta*

*Nëna ime
Rruzare xhevahiresh*

*Në kopshtin e zemrës tënde
Flijimi ka rrënjët*

Kënga me nota dielli

*Kurrë
Nuk
Ia
Kuptova
Këngën qyqes
As ngjyrën
E korbit
Se kuptova
Si mungesën e këmbëve
Te gjarpërinjtë
Fluturimin e shqiponjës
Krahët e engjëllit ma shpjegojnë
E kënga ime
Komponim dashurie
Me nota dielli
Mbet*

Zbrazëtirë

*Valët e detit vdiqën
Buzëmbremja duke u zgjuar bie
Guaca e yje deti
Dremitën nën strehë rëre
Vrapi i mallit m'u ndal
Tek rreth i horizontit
Me ngjyrën e kuqërremtë
Dashurinë pikturova
Ah ti matanë këndeje unë vetëm
Nën qiell yjesh njësoj
E valtë dashuria më copëton
Shpirtin atëherë nis ta kujtoj*

Meditim

*Ndër dhëmbët
E brengave*

*Koha zhduket
Zemra ime
Me nota violine
Shkruan simfoni
Shiu bie
Akuj me thepa
Pa mbarim
Duke ia shtrembëruar
Emrin malit
Mezhdave
Lulëkuqet mbeten
Pasthirrmë*

Ik

*Kur të duash mbylle derën
Atje të presin kujtimet e mia
Janë kudo
Me ajër mbështjellë
Tek fole e thurur
Me rrënjë zemre
Dhembja përtërinë
Fuqinë
Ik
Shtratin
Me ëndrrat e mia
Shtroje
Në mëngjes
Shkundi mbi vesë
Dhe shkel mbi to
Unë do t'i thaj lotët
Tek pasqyre e diellit
Ti i mbyllur tek dhembja
Jeto*

Historia

Mbi shpatullat e mia

*Rrotullohesh
Gjarpërinjtë
Presin rënien time
Të helmëta dëshira
Trazojnë ajrin
Unë eci drejt malit tim
Rrugëve ilirishte
Nga qiejt e zbardhur
Perënditë pellazge
Më spërkatën dashurinë
Një ditë
Do të perëndoje ligësia
Të frymojë lirshëm
Njerëzia*

Piktura

*Në bardhësi pëlhure
Sytë kornizë
Zemra në mes si gjithnjë
Gjaku vërshon në vend lumi
Këmbët trung
Me duar të degëzuara
Ëndrrat rrugë me pjerrtësi
Galeria e shpirtit sa e çuditshme
Me panel plot ngjyra vuajtjesh
I bartë kah të shkojë
Jeta*

Gjëma

*Karvan shkretëtire pasioni
Bulëzim djerse e ftohti
Ma mbulon ballin
Qielli i brengave
Me ngjyrën e vet më përpin
Dua të bërtas
Po kush më dëgjon*

*Mespërmes pabesia
Shkel mbi trupin tim
Rërë e tharë
Zhgënjimi
Në rrugë shkretëtire
Shtohet pa fund*

Shiu

*Brengen time
Në lot e ktheu qielli
Nga qepallat e reve
Trishtimi i rrebeshtë bie
Reja si demon
Kujtimet suvenire
M'i hedh mbi fytyrë
Koha dyzohet
Qyqe pabesia
E veshur me tradhti
Thur himne
Mashtrimin e lartëson
Pasioni im
Pëlçet në horizont
Në këtë kohë*

Kohë kuturu

Kuturu

*Flutura ma solli
Porosinë tënde
Mos fol
Dhembjet i varrosa
Në parmak
Tani kam lule
Ujitur me lotin
E acareve
Me flatra pëllumbash
Retrospektiva*

*U zhduk
E di*

Kali i Trojës

*Si në eklips
Nata errësuar
Pa yje*

*Në ftohtësi mermeri
U përmbys bota*

*Nga barku i kalit
Ushtarët
Trojën e nxinë*

*Copa trupi
Ushtarësh të vdekur
Varur mureve*

Të tradhtisë peng

*Në logun e betejës
Nuk vdiqën*

*Me kalin e vdekur
I vranë*

Rizgjimi i bukur

*Me rreze hëne
U ndritë nata
E valtë lumturia
Ndjenjën ma pushtoi
Shkumbëza e detit
Si lule orkide
Ëndrrat m'i dehu*

Një natë shetie rreth detit

*Mbi një cep qielli
Të shpirtit
Fluturim i pulëbardhës
Një kujtim ma rizgjoj*

Mbyllur në kujtim

*Hëna m'i përgjoi
Mendimet*

*Në konstelacion yjesh
Pamja jote
Më vezulliu*

*But e ledhatova
Dëshirën e ëndrrës*

*Me lotin u mbylla
Te kujtimi*

Fjala e papagallit

*Për vetminë e Robinson Krussos
Foli papagalli mbrëmë*

*Malet narracionin e mësuan
përmendësh*

Po Krussoja kujt i tha

*Vetmia më ndoqi
Duke kërkuar njeriun*

Përjetësi kënge

*Sofrën me bukë mrume
Koliqi e ka të shtruar*

Nga thepmajat

Zë kushtrimi bie

*Lasgushi këndon
Me lotin e mallit*

*Mespërmes Shqipërisë
Me lot Drini në syrin e amshimit*

Dëshirat

*Këmbëzbathur
Luadheve tua
Kam shkelur vesën
Mëngjeseve të ftohta
Që të rritem për një ditë*

*Qiellin ëndërroja
Ta preku
Tek ngjyrë ylberi
Të jem lot i qeshur
I dhembjeve tua*

*Lakenjtë që të gjakosnin
Me rrufe
T'i largoj desha*

*Në panteon
Ta shkruaj emrin
Me trupin tim*

*Kosovë
Dashuria ime
E pambarim*

Njeri perëndi (Vëllaut Kadriut)

*Me rrufe torturash
Trupin tënde të flashkët*

E goditën gjakësorët

*Të freskëta
Blerime tëmbëlore
Vitet e tua*

*Ligësi përbindëshash
Lakuni të uritura ishin
Çnjerëzorët*

*Mbi plagën tënde
Ylber degëzohej liria*

*Në kaltërinë e qiellit
Sa herë betuar ishe*

*Njëmijë herë lindje
Blerimit me ju fal*

*Nuk dini ç 'bëni
Ishte fjala jote*

*Si promete
U ringjalle*

Çast

*Rrezet e ngazëlluara
Gudulisin syçkat e luleve*

*Tek luadhi i fluturave
Gjithçka shkëlqen
Për pikturim*

Ah

*Po frymëzimi im ku mbeti
Dora u shtang tek paneli*

*Pikëllimi lëshoi vellon
U stolis në trupin tim*

Krahasim

*Në çfarë ngjan loti
Po deti në çfarë ngjanë
Me njërin
Peshoj mallin
Zemrën
Me tjetrin zgjeroj*

Ecje nëpër qiell

*Sa gjatë eca
Nëpër qiell
Duke kërkuar
Ta ndjej
Dheun e ngrohët*

Pse

*Në kokë Krishtit i vunë gjemba hekuri
E me gozhdë këmbët ia shpuan
E pyeta një të ri slloven
Valle bota te ketë qenë çmendur
E çmendur është dhe tani
Më tha ai i ri*

Kur jam me ty

*Në çdo stinë
Gjelbëron behari
Trishtimi
Se ku ik nuk e di
Gjithçka
Merr kuptimin e vet
Kur ti
Emrin tim thërret*

Kohët

*Fara kërkonte tokën
Filizat të diellit ngrohtësi
Në horizonte ligësia zgërdhihej
Jargë pabesie spërkatnin Shqipërinë
Na ishte njëherë si tani
Po për të nesërmen
Kush e di*

Te kalaja

*Zonjë hijerëndë
Duket Emona
Kur e vështroj nga kalaja*

*Në majën e pirgut
Dalloj shkronjën e emrit tim*

*Ndër gështenja
Dëgjoj këngë zogjsh
Si në Kosovë*

Gati në fund jam

*Në fushat e dimrave
Acari më ngrin
Edhe një pikë gjaku më ka mbetur
Deri të pranveron dielli*

Afër

*Unë edhe ti
Nën një strehë qielli
Aq afër
Dëshira fërfërinë
Por nuk flasim
Krenarinë*

*Nuk duam
Ta vrasim*

Mos

*Mos me lëndo
Se flutur bëhem
E më merr qielli*

*Mos me përbuz
Pse urrejtjes
Ngjyrën nuk ia njoh*

*Mos ik
Kur mbi dhembje
Dashurinë e përgedheli*

*Rri me mua
Ta ngjyrojmë
Ditën*

Poezi »Rozafa«, Prishtinë

P ë r m b a j t j a

Dans korbash

- 1. Dans korbash*
- 2. Plagët e gjalla*
- 3. Në krahë engjëjsh*
- 4. Në Trieshtë*
- 5. Mëkati i bukur*
- 6. Reliev zemre*
- 7. Filli i ri*
- 8. Lutja*
- 9. Pafundësia e marrëzisë*
- 10. Ëndrra e trishtë*
- 11. Vetëm unë e di*
- 12. Të pagjeturit*

13. *Dhembje malli*
14. *Ecja monotone*
15. *Lumi*

Vdekja e ditëlindjes

16. *Në vend të parathënies*
17. *S'të pash më*
18. *Dheu atdhe*
19. *Unë gruaja*
20. *Mesazh në telefon*
21. *Jeta*
22. *Larg teje*
23. *Qartësi*
24. *Vdekja e ditëlindjes*
25. *Nëna ime rruzare*
26. *Kënga me nota dielli*
27. *Zbrazëtirë*
28. *Meditim*
29. *Ik*
30. *Historia*
31. *Piktura*
32. *Gjëma*
33. *Shiu*

Kohë kuturu

34. *Kuturu*
35. *Kali i Trojës*
36. *Rizgjimi i bukur*
37. *Mbyllur në kujtim*
38. *Fjala e papagallit*
39. *Përjetësi kënge*
40. *Dëshirat*
41. *Perëndi njeri*
42. *Çast*
43. *Krahasim*
44. *Ecje nëpër qiell*
45. *Pse*

46. *Kur jam me ty*
47. *Kohët*
48. *Tek kalaja*
49. *Gati në fund jam*
50. *Afër*
51. *Mos*

(Përgatiti moderatori i pashtriku.org)
